



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE

Zyra e Kryeprokurorit

AD.nr.2/2025

Më datë: 11 Mars 2025

Gjilan

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan si autoritet kompetent, merr këtë:

VENDIM

HUDHET, ankesa e paraqitur nga pala ankuese [REDAKTUAR] për shkelje disiplinore nga prokurori [REDAKTUAR] – prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan/Departamenti Përgjithshëm.

Arsyetimi

Më datën 27 shkurt 2025, nga pala ankuese [REDAKTUAR] kemi pranuar një ankesë drejtuar Prokurorisë së Apelit, e që në përmbajtje është nënkuptuar edhe si ankesë disiplinore ndaj prokurorit [REDAKTUAR] – prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan/Departamenti Përgjithshëm, lidhur me mostrajtmin adekuat të rastit penal [REDAKTUAR] në të cilin rast pala ankuese [REDAKTUAR] është palë e dëmtuar.

Më datë 07 Mars 2025, konform nenit 9 par. 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, për pranimin e ankesës nga pala ankuese [REDAKTUAR]

Pala ankuese [REDAKTUAR] në ankesë ka pretenduar se prokurori i shtetit [REDAKTUAR] nuk ka trajtuar në mënyrë adekute rastin me numër [REDAKTUAR] dhe përmes ankesës së tij drejtuar Prokurorisë së Apelit ka kërkuar që të ekzaminohet në tërësi mbarëvajtja ligjore e këtij

rasti dhe se personat përgjegjës, në këtë rast prokurori i shtetit [REDACTED] a ka vepruar konform dispozitave ligjore.

Më tutje i njëjti, ka theksuar se në këtë rast prokurore kujdestare ka qenë prokurorja e shtetit [REDACTED] tek e cila vazhdimisht ka kërkuar që të ndërmerre veprime ligjore brenda kompetencave dhe përgjegjësi, në mënyrë që të njëjtit të i mundësohet vazhdimi i operimit të punës së biznesit të tij, respektivisht që të hapin derën e lokalit, duke e larguar paraprakisht dryrin e vendosur nga personat tashmë të akuzuar, në rastin me numër [REDACTED]

Gjithashtu, pala ankuese ka pretenduar se pavarësisht kërkesave zyrtare të tij tek prokurorja kujdestare [REDACTED] dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës së paraqitur nga pala ankuese [REDACTED] me qëllim të verifikimit të këtij dyshimi është analizuar edhe njëherë kjo çështje lidhur me rastin me numër [REDACTED], pasi për këtë rast nga e njëjta palë ankuese, për të njëjtin rast, më datën 22 Janar 2025 është pranuar ankesë për shkelje disiplinore nga prokurorja kujdestare [REDACTED], për shkak të mostrajtimit adekuat të kësaj çështjeje penale, ku më datën 06 Shkurt 2025, në pajtim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, është marrë vendim me të cilin është hudhur ankesa e paraqitur nga pala ankuese [REDACTED] për shkelje disiplinore ndaj prokurores [REDACTED] i [REDACTED] pasi është vërtetuar se në veprimet e saj nuk është identifikuar asnjë shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrave dhe autorizimeve të saj.

Prokuroria Themelore në Gjilan, më datë 17 Janar 2025 ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës me numër [REDACTED] ndaj të dyshuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] i cili përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) është ndarë në punë në Departamentin e Përgjithshëm, tek prokurori [REDACTED]

Prokurori i shtetit [REDACTED] pas pranimit dhe analizimit të kallëzimit penal, më datën 31 Janar 2025 ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer këto vepra penale:

- "Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve" nga neni 197 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),
- "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" nga neni 321 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe,

- "Vetëgjyqësia" nga neni 410 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Nga të gjitha të lartcekurat, vijmë në përfundim se prokurori i shtetit [redacted] i ka analizuar në përpikmëri këtë çështje penale, për të cilën në afat optimal edhe ka ngritur aktakuzë dhe se në veprimet e tij nuk është identifikuar asnjë shkelje disiplinore.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore dhe arsyet faktike të cilat u cekën më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KRYEPROKURORI

Arben Kadriu

Kopje/njoftim konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve:

1x1 kopje, z. Ardian Hajdaraj, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;

1x1 kopje, [redacted]

1x1 kopje, arkivës.